

Për:	Operatorë Ekonomik: Kompania e pastrimit Donarti shpk me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **05.09.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Kompania e pastrimit Donarti shpk** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, nxjerr:

NJOFTIM

- I. **Hedhet poshtë** si e jashtë afatshme Kërkesa për Rishqyrtime, e datës: **05.09.2025**, parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Kompania e pastrimit Donarti shpk** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **24.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **Kompania e pastrimit Donarti shpk** me adresë në **Prishtinë**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim, me datë: **05.09.2025**, në Ora: **14: 37^h**

Shih tabelën nëpërmjet sistemit te e-prokurimit:

Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi kërkesës	Afati i fundit për vendim	Detajet
05.09.2025 14:37	Kompania E Pastrimit Donarti SH.P.K.	Kerkesa per rishqyrtim	Paraqitur	5h 49m 52s	

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Në bazë të **Nenit 5 Kalkulimi i afateve kohore** të LPP-së:

- **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit.** Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.
- Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Bazuar ne Rregulloren e Prokurimit Publik Nr. 001/2022, Neni 60 pika a) dhe Neni 60.2 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore:

- **Paragrafi 60.1** Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “ kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:
- **pika a) - Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.** Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.
- **Paragrafi 60.2** - Është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim që kërkesa të përgatitet dhe dërgohet në autoritet kontraktues para skadimit të afatit të fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim. Nëse parashtruesi dështon të përgatitë dhe paraqesë kërkesën për rishqyrtim brenda afateve kohore për arsye të çfarëdo problemi teknik që ndodhë në dy (2) orët e fundit para skadimit të afatit të fundit për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim, përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi i kërkesës.

Bazuar ne INTERPRETIMIN e KRPP-së:

35. 04.12.2023 Si te kalkulohet afati kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së?

1. Në përputhje me nenin 60.1, a) të RRPP, në rast se AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë, **dita e fundit e dorëzimit të ofertave është dita “zero” e pesë ditëve të afatit ankimor në AK dhe ky afat fillon të kalkulohet në mënyrë retroaktive.**

Për shembull: Nëse **Njoftimi për Kontratë** apo dokumentet e tenderit janë publikuar (janë ngritë në sistem) me datë **05.10.2023** ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar me datë **15.11.2023**. Afati fillon të kalkulohet në mënyrë retroaktive duke filluar nga dita e dorëzimit të ofertave: **14, 13, 12, 11, 10** dhe rrjedhimisht **afati i fundit kur një OE mund të parashtojë kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së është data 09.11.2023 deri në ora 16:00**. Pra në këtë rast, OE mund të parashtojë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë e deri me datë 09.11.2023 para orës 16:00.

Nga Shembulli i lartcekur i Interpretimit të KRPP-së:

Për aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**

Njoftimi për Kontratë dhe Dokumentet e tenderit janë publikuar, janë ngritë në sistem <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, me datë: **24.07.2025** ndërsa **afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar me datë: 08.09.2025**

Afati fillon të kalkulohet në mënyrë retroaktive duke filluar nga dita e dorëzimit të ofertave: **07, 06, 05, 04, 03** dhe rrjedhimisht **afati i fundit kur një OE mund të parashtojë kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së është data: 02.09.2025 deri në ora 16:00**.

Pra në këtë rast, OE mund të parashtojë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë e deri me datë: **02.09.2025 para orës 16:00**.

Autoriteti Kontraktues pas pranimit te Kërkesës për Rishqyrtim ka konstatuar se kjo kërkesë është jashtafatshme dhe ne kundërshtim me LPP-në Neni 5 dhe Rregulloren per Prokurim Publik Neni 60, ndërsa Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ka vazhduar me aktivitetin e prokurimit.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>